



DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZGJERIM

UDHËZIME MBI  
MBËSHTETJEN E BE-SË  
PËR SHOQËRINË CIVILE  
NË VENDET E ZGJERIMIT  
2014-2020



Bashkimi Europian

# 1. SHOQËRIA CIVILE DHE DEMOKRACIA PJESËMARRËSE



Traktati i Bashkimit Evropian (Neni 49) parasheh që çdo shtet evropian që respekton dhe angazhohet për promovimin e parimeve të dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat e personave që u përkasin pakicave, mund të aplikojë për t'u bërë anëtar i Unionit.

Një shoqëri e fuqizuar civile mund të luajë rol të rëndësishëm për të garantuar mbështetjen e këtyre parimeve në praktikë. Ajo është në vetvete një përbërës vendimtar i çdo demokracie. Duke artikuluar brengat e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) – të cilat kuptohen si struktura joshtetërore, joprofitabile ku njerëzit organizohen për të ndjekur synime dhe ideale të përbashkëta<sup>1</sup> - janë aktive në arenën publike dhe angazhohen në iniciativa që përkrahin pluralizmin dhe demokracinë pjesëmarrëse.

Vendet e zgjerimit përballen me një varg sfidash, sidomos në fusha të tilla si ushtrimi i ligjit, korrupsioni, krimi i organizuar, ekonomia dhe kohezioni social. Aktorët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të japin kontribut të rëndësishëm në trajtimin e shumë prej tyre, me anë të lobimit, përkrahjes dhe aktiviteteve mbikqyrëse në nivel nacional, rajonal dhe lokal. Kur bëhet fjalë për qeverisjen demokratike, si dhe ushtrimin e ligjit dhe të drejtave fundamentale, përfshirë këtu lirinë e të shprehurit

<sup>1</sup> Definicioni nga COM(2012) 492 final: Rrënjët e demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm: angazhimi i Evropës me Shoqërinë Civile në Veprimtarinë e Jashtme – Bruksel 12/09/2012

dhe asocimit dhe të drejtat e pakicave, ato mund të krijojnë kërkesën për transparencë më të madhe, përgjegjësi dhe efikasitet të institucioneve publike dhe të ofrojnë fokusim më të madh mbi nevojat e qytetarëve në hartimin e politikave. Organizatat e shoqërisë civile në rajon kanë demonstruar aftësinë e tyre për të ndërmarrë iniciativa efikase kundër korrupsionit, për të dhënë kontribut drejt integritetit rajonal dhe proceseve të pajtimit, për të mbështetur mediat e pavarura, për të bërë fushatë lidhur me barazinë gjinore, luftën kundër diskriminimit, si dhe për të promovuar përfshirjen sociale dhe politikën dhe përvajtjet e qëndrueshme të mjedisit.

Përveç kësaj, përfshirja e shoqërisë civile në procesin para-anëtarësues mund të kontribuojë që qytetarët më hollësisht të kuptojnë reformat që një vend duhet t'i përfundojë, në mënyrë që të kualifikohet për anëtarësim në BE. Kjo mund të ndihmojë që të sigurohet se anëtarësimi në BE nuk është vetëm një ushtrim qeveritar dhe të stimulojë debat të ekuilibruar publik, i cili është vendimtar për arritjen e një vendimi të informuar mirë, lidhur me anëtarësimin e BE-së në fund të procesit para-anëtarësues.

## 2. AGJENDA E ZGJERIMIT PËR SHOQËRINË CIVILE

Mbështetja e shoqërisë civile në suaza të politikës së zgjerimit<sup>2</sup> duhet të përqëndrohet në ofrimin e mundësisë për demokraci pjesëmarrëse dhe stimulimin e saj. Kjo duhet të pasqyrohet në dy qëllime kryesore: arritjen e një mjedisi të favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapacitetit të Organizatave të Shoqërisë Civile për të qenë aktorë të pavarur efikasë dhe përgjegjës.

### 2.1 Mjedis i favorshëm

Një vend që dëshiron të anëtarësohet në BE, duhet të ketë **mjedis** të përshtatshëm **ligjor, gjyqësor dhe administrativ** për të ushtruar liritë e të shprehurit, tubimit dhe organizimit. Kjo përfshin të drejtat e Organizatave të Shoqërisë Civile, siç janë procedurat e formalizuara, transparente dhe jo-diskriminuese të regjistrimit, funksionimi i lirë dhe i pavarur dhe bashkëpunimi mes qytetarëve dhe mungesa e ndërhyrjes disproporcionale apo e pajustificuar shtetërore.

Një **mjedis i përshtatshëm financiar** është i nevojshëm për të bërë të mundur zhvendosjen e këtyre të drejtave në praktikë. Në shumicën e shteteve anëtare të BE-së, legjislati ofron beneficione për OShC-të që ndjekin veprimet e konsideruara si interes publik; kjo mund të arrihet me anë të rregullave të favorshme tatimore për donacionet private, me kuotat e anëtarësimit dhe me filantropi. Të tjerët ofrojnë fonde direkte publike.

Veç kësaj, pjesëmarrja e shoqërisë civile është faktor kyç për të siguruar legjislati gjithëpërfshirës cilësor dhe për të zhvilluar politika të qëndrueshme që pasqyrojnë nevojat e njerëzve dhe të cilat pranohen nga ata, të cilët më së shumti shqetësohen prej tyre. Kjo vlen edhe për reformat që duhet t'i implementojë një vend për t'u kualifikuar për anëtarësim në BE. Është jashtëzakonisht me rëndësi

<sup>2</sup> Kjo vlen kryesisht për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, mirëpo, Islanda dhe komuniteti qipriot turk mund të bashkohen aty ku është e përshtatshme, përfshirë këtu edhe mësimin nga përvajtjet dhe këmbimin e tyre.

zotërimi i **strukturave dhe mekanizmave adekuate për bashkëpunimin e shoqërisë civile me institucionet publike** si dhe rrjedha e lirë, e qartë dhe e hapur e informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të strukturuar jetëgjatë.

### 2.2 Kapaciteti i OShC-ve

Organizatave të Shoqërisë Civile kanë forma të ndryshme dhe operojnë në nivele të ndryshme të formalitetit. Komisioni do të angazhohet me OShC-të që janë të përkushtuar për forcimin e kapacitetit të tyre drejt plotësimit të synimeve të veta. Para së gjithash, është e nevojshme që shumë OShC të përmirësojnë **autonominë, përfaqësimin dhe përgjegjësinë** e tyre, duke forcuar bazën e tyre të anëtarësimit, me standarde më të larta të qeverisjes së brendshme, përfshirë këtu strukturat demokratike, mbikqyrjen dhe vlerësimin, menaxhimin financiar, transparencën<sup>3</sup>, shpërndarjen gjeografike dhe bashkëpunimin. Për më tepër, OShC-të mund të shtojnë efikasitetin e tyre duke rritur kapacitetin e vet për analizë, mbikqyrje dhe përkrahje, si dhe rrjetëzim, partneritet, ndërtim koalicioni dhe përfshirje aktive në proceset e hartimit të politikave dhe ligjeve. Së fundi, qëndrueshmëria financiare kërkon zhvillim të anëtarësimit dhe kapacitet të përmirësuar për mbledhjen e fondeve të shumëllojshme që synojnë publikun dhe burimet private të të ardhurave.

## 3. MBËSHTETJA E BE-së

Komisioni do të ofrojë një kombinim të mbështetjes politike dhe financiare për t'i plotësuar këto prioritete, duke përdorur një qasje më strategjike, më efektive dhe të fokusuar në rezultate, për të dhënë ndikimin maksimal me burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion.

Në **mbështetjen e vet politike**, Komisioni do t'i inkurajojë vendet e zgjerimit të bëjnë legjislati më të favorshëm për shoqërinë civile.<sup>4</sup> Gjithashtu do të promovojë përfshirjen e shoqërisë civile në procesin para-anëtarësues, duke përfshirë formulimin, implementimin dhe mbikqyrjen e strategjive të sektorit për ndihmë financiare të BE-së, e cila do të forcohet në kuadër të IPA II.<sup>5</sup>

**Ndihma financiare** e Komisionit do të shfrytëzojë një përzierje të përshtatshme të instrumenteve financiare<sup>6</sup> për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të OShC-ve dhe konteksteve të vendit në mënyrë fleksibile, transparente, me fokus në koston efektive dhe rezultatet, e cila gjithashtu merr parasysh barrën administrative për Komisionin. Kjo do të përfshijë: synimin për kontrata më afatgjata, njohjen e ndërtimit të kapaciteteve dhe përkrahjen e cila ka nevojë për kohë dhe burime; lëvizja nga përkrahja e bazuar në projekt drejt një qasjeje më fleksibile që kultivon partneritetin dhe ndërtimin e koalicionit; dhe

<sup>3</sup> Për shembull puna drejt aderimit me standardet e Iniciativës për Transparencë të Ndhmës Ndërkombëtare (IATI), të cilën e ka nënshkruar Komisioni Evropian

<sup>4</sup> Se a duhet kjo të pasqyrohet në mënyrë sistematike në raportet vjetore të progresit, kjo do të vendoset në fazë të mëvonshme.

<sup>5</sup> Implementimi i strategjive sektoriale për ndihmë financiare të BE-së synon zgjerimin e pronësisë nacionale mbi politikën e sektorit publik dhe ndarjen e burimeve, duke rritur koherencën mes policisë, shpenzimeve dhe rezultateve. Strategjitë sektoriale do të zhvillohen nga qeveritë nacionale, dhe në sektorët e caktuar, do të implementohen me ko-financim të BE-së.

<sup>6</sup> Komisioni mund të marrë parasysh të gjitha instrumentet e financimit dhe qasjet e parashikuara në Rregullativën Financiare. Këto përfshijnë projekte, financime të programeve, çmime direkte, financim i grumbulluar, grante, thirrje të thjeshtësuara dhe grante të sërishme.

punë e zellshme për të arritur në organizatat bazë, sidomos me grantet e sërishme dhe mekanizmat fleksibilë të mbështetjes për t'u përgjigjur nevojave të tyre të menjëhershme. Partnerët socialë luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e të drejtës së asociacionit dhe prandaj duhet të mbështeten për të përmirësuar veprimin e tyre. Perspektiva e partnerëve socialë dhe shoqatave profesionale dhe të biznesit duhet shqyrtuar gjithashtu në punën e Komisionit. Duhet të forcohen edhe partneritetet midis këtyre organizatave, sidomos atyre nga rajonet e pafavorizuara me homologët e tyre në BE. Shoqëria civile do të mbështetet edhe nga programet sektoriale<sup>7</sup> me anë të masave që shtojnë rolin dhe kapacitetet e tyre për të marrë pjesë aktive në formulimin dhe implementimin e strategjive sektoriale për ndihmë financiare të BE-së.

Komisioni pranon se një kulturë e vërtetë e qytetarisë aktive nuk mund të krijohet me ndihmë financiare vetëm nga jashtë. Donatorët e jashtëm mund të ndikojnë mbi aktivitetet e shoqërisë civile në masë të madhe. Organizatat që varen jashtë mase nga financimi ndërkombëtar ose vendor publik, në disa raste mund të mos konsiderohen si shoqëri e vërtetë civile dhe rrezikojnë delegjitimizimin e aktiviteteve të tyre në sytë e publikut.

Duhet gjithashtu të kuptohet se financimi i BE-së që ka të bëjë me anëtarësimin, është i kufizuar në vëllim dhe në kohë. Edhe pse ka qenë një donator i madh i Shoqërisë Civile, BE-ja nuk mund dhe nuk duhet të synojë për të mbushur boshllëkun e financimit të mbetur pas largimit të donatorëve të tjerë nga rajoni. Me lëvizjen e vendeve të zgjerimit drejt aderimit, Komisioni do të mbështesë OShC-të që të bëhen më pak të varura nga financimet e donatorëve ndërkombëtarë, duke përfshirë këtu edhe financimin e BE-së, siç është përcaktuar në Pjesën 2.



<sup>7</sup> Për shembull, do të ketë disa masa në kuadër të IPARD që do të trajtojnë nevojat e grupeve lokale të veprimit (masa LEADER dhe masa e organizatave të prodhuesve).

## 4. MATJA E REZULTATEVE DHE NDIKIMIT

Komisioni do të zhvillojë disa objektiva, rezultate dhe tregues të mbështetjes së BE-së për shoqërinë civile, të cilat do të mundësojnë matjen e progresit në nivel të vendit si dhe në gjithë rajonin e zgjerimit, duke përfshirë këtu edhe perspektivën gjinore. Sistemi i mbikqyrjes dhe vlerësimit do të përfshijë mbledhje vjetore rajonale me përfshirjen e OShC-ve, për të analizuar rrethanat dhe avancimin drejt qëllimeve. Meqenëse kjo mund të shërbejë si input për raportet vjetore të progresit, pulset politike do të jenë të bashkuara.

### SHTOJCA A: MBIKQYRJA DHE VLERËSIMI DHE KORNIZA E REZULTATEVE TË PROPOZUARA

Implementimi i mbështetjes për shoqërinë civile duhet të përfshijë mbikqyrjen dhe sistemet e vlerësimit në nivele të ndryshme:

- OShC-të do të përfshihen në mbikqyrjen vjetore të treguesve dhe rezultateve me mbështetjen nga TACSO, programi i ndihmës teknike të financuar nga BE-ja për OShC-të në rajonin e zgjerimit. Mbledhjet vjetore nacionale dhe rajonale do të analizojnë zhvillimin e OShC-ve në të gjitha vendet dhe avancimin drejt qëllimeve.
- Sistemet e koordinuara për mbikqyrjen e granteve do të zhvillohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese (Selia ELARG, Delegacionet, Autoritetet Nacionale). TACSO mund të ndihmojë në këto përpjekje me udhëzime dhe ndërtimin e kapaciteteve.
- Vlerësimi afatmesëm i mbështetjes të Zgjerimit për OShC-të në vendet e zgjerimit, duhet të bëhet në gjysmë të periudhës deri në vitin 2017, për të vlerësuar progresin drejt synimeve dhe rezultateve, si dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme të strategjisë.
- Vlerësimi përfundimtar duhet të autorizohet në fund të periudhës (2020) për të siguruar inputet e nevojshme pas përfundimit të kornizës aktuale financiare.

Korniza e propozuar e rezultateve është hartuar në pajtim me synimet e përcaktuara në udhëzimet për mbështetje të BE-së për shoqërinë civile 2014-2020. Kjo kornizë është konceptuar si kornizë për rajonin e zgjerimit në tërësi dhe do të sigurojë bazë për një qasje të veçantë në nivel nacional, në pajtim me kontekstin e vendit. Treguesit janë definuar në konsultim me OShC-të dhe pjesëmarrësit e tjerë gjatë evenimentit të këmbimit të ideve në muajin prill 2013. Të njëjtat janë duke u rafinuar edhe më tej duke i konsideruar ato nga pikëpamja operative/ e lehtë për vlerësim.

Synimet	Rezultatet	Treguesi	MoV
<b>Mjedis i favorshëm</b>			
<b>1.</b> Mjedis i përshtatshëm ligjor dhe politik, për ushtrimin e të drejtave të lirisë, të shprehurit, tubimit dhe asociimit.	<b>1.1</b> Të gjithë individët dhe subjektet ligjore mund të shprehen lirshëm, të tubohen qetësisht, të bashkohen dhe të marrin pjesë në organizata joformale/ ose të regjistruara	<b>1.1.a</b> Numri i rasteve të shkeljes së të drejtave themelore kushtetuese të individëve dhe subjekteve ligjore për t'u shprehur lirshëm, për tubim, për grumbullim dhe/ ose pjesëmarrje në organizatë joformale dhe/ ose të regjistruar, dhe nga këto, numri i rasteve të hetuara në kohë dhe të sanksionuara (të zbërthyer për t'i treguar rastet e mbrojtjes të të drejtave të njeriut)	<b>1.1.a</b> ACMIS baza e të dhënave të gjykatës dhe/ose praksa gjyqësore e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut Sistemet e menaxhimit të rasteve gjyqësore, Raportet vjetore të Ombudsmanit shqiptar, Raportet e Komisionit Shtetëror kundër Diskriminimit.
	<b>1.2</b> Politikat dhe mjedisi ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë vullnetarizmin dhe punësimin në OShC;	<b>1.1.b</b> Vlerësimi i cilësisë të legjislacionit ekzistues dhe kornizës së politikës  <b>1.1.c</b> Progresi me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant	<b>1.1.b</b> Përmes vlerësimit të pavarur  <b>1.1.c</b> Vlerësimi me anë të Raportit Vjetor të Progresit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim

Synimet	Rezultatet	Treguesi	MoV
<b>Mjedis i favorshëm</b>			
<b>2.</b> Një mjedis i favorshëm financiar që mbështet qëndrueshmërinë e OShC-ve.	<b>1.3</b> Autoritetet nacionale dhe/ ose lokale kanë politika të favorshme dhe rregulla për organizatat bazë*.	<b>1.3.a</b> Cilësia e mjedisit të favorshëm për organizatat bazë	<b>1.3.a</b> Përmes vlerësimit të pavarur  Definimi i organizatave bazë i përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme DEVCO  (organizim i një lloji recensionit kolegjial i kornizave ligjore që kanë të bëjnë me OShC-të)
	<b>2.1</b> Rregulla të lehta për t'i përbushur për OShC-të, të cilat janë proporcionale për të ardhurat dhe aktivitetet e tyre jokomerciale;	<i>*Një organizatë bazë është grup i vetëorganizuar i individëve që ndjekin interesat e përbashkëta përmes një organizate vullnetare dhe jofitimprurëse. Organizatat bazë zakonisht kanë nivel të ulët të formalitetit por qëllim më të gjerë se sa grupet vetë-ndihmuese në bazë të problemit, organizatat e bazuara në komunitet ose shoqatat fqinjësore.</i>	<b>2.1.a</b> Perceptimi i OShC-ve lidhur me lehtësinë dhe efikasitetin e rregullave financiare dhe kërkesat raportuese (të zbërthyer sipas llojit / madhësisë së OShC-ve)  <b>2.1.b</b> Vlerësimi cilësor i rregullave financiare (me fokus mbi mekanizmat e ndërtuar që rregullat dhe obligimet financiare të ndryshojnë me ndryshimin e të ardhurave dhe aktiviteteteve jokomerciale).  <b>2.1.c</b> Përqindja/ përpjestimi i tatimeve dhe obligimeve financiare në buxhetin e përgjithshëm në dispozicion (Specifikuar sipas shpenzimeve dhe aktiviteteteve të implementuara)

Synimet	Rezultatet	Treguesi	MoV
<b>Mjedis i favorshëm</b>			
	<b>2.2</b> Donacionet stimulohen me legjislacion dhe rregullativa adekuate	<b>2.2.a</b> Numri dhe lloji i donacioneve për OS-hC-të, nga donatorë privatë dhe të korporatave (specifikuar në vlera monetare) <b>2.2.b</b> Cilësia dhe zbatueshmëria / 'implementueshmëria' e zbritjes për donacionet individuale dhe të korporatave të përcaktuara me legjislacione dhe rregullativa (përfshirë këtu zberthimin në llojet e donacioneve që mund të zbriten)	<b>2.2.a</b> Drejtoria e të Ardhurave Publike, Baza e të dhënave e Ministrisë së Drejtësisë për Donacione dhe Sponsorizime, Raportet vjetore financiare nga OS-hC-të <b>2.2.b</b> Me anë të sondazhit (shqyrtim kolegjial)
	<b>2.3</b> Përfitimet financiare janë në dispozicion (p.sh. tatim ose në natyrë)	<b>2.3.a</b> Përqindja e OS-hC-ve që përfitojnë nga stimulimet tatimore <b>2.3.b</b> Cilësia e sistemit të beneficioneve tatimore për aktivitetet operationale dhe ekonomike të OS-hC-ve	<b>2.3.a</b> Regjistri qendror, Drejtoria e të Ardhurave Publike, regjistra të tjerë nacionalë <b>2.3.b</b> Përmes vlerësimit të pavarur
	<b>2.4</b> Mbështetja qeveritare për OS-hC-të është në dispozicion dhe ofrohet në mënyrë transparente, të përgjegjshme, të drejtë dhe jodiskriminuese	<b>2.4.a</b> Perceptimi i OS-hC-ve për sigurimin e fondeve në aspekt të transparencës, drejtësisë dhe jodiskriminimit <b>2.4.b</b> Përqindja e sumës së kërkuar përballë sumës së miratuar /zberthyer në vjet me anë të financimit shtetëror për OS-hC-të. (kjo vërteton dispozicionin e fondeve) <b>2.4.c</b> Cilësia e kornizave të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile (që fokusohen në dokumentin procedural)	<b>2.4.a</b> Sondazh <b>2.4.b</b> Raportet vjetore të publikuara nga Ministrinë që ofrojnë ndihmë financiare për OS-hC-të. <b>2.4.b</b> Përmes vlerësimit të pavarur

Synimet	Rezultatet	Treguesi	MoV
<b>Mjedis i favorshëm</b>			
<b>3.</b> Shoqëria civile dhe institucionet publike punojnë në partneritet për dialog dhe bashkëpunim, në bazë të vullnetit, besimit dhe pranimit reciprok rreth interesave të përbashkëta	<b>3.1</b> Institucionet publike njohin rëndësinë e OS-hC-ve në përmirësimin e qeverisjes së mirë gjatë përfshirjes së OS-hC-ve në proceset e vendim-marrjes	<b>3.1.a</b> Përqindja e ligjeve/ akteve nënligjore, strategjive dhe reformave të politikës të konsultuara në mënyrë efektive* me OS-hC-të  * në aspektin e: <ul style="list-style-type: none"> <li>• qasjes adekuate në informata</li> <li>• kohës së mjaftueshme për të komentuar</li> <li>• zgjedhjes dhe përfaqësimit / shumëllojshmërisë të grupeve të punës</li> <li>• pranimi i inputit</li> <li>• niveli në të cilin merret parasysh inputi</li> <li>• reagimi/ publikimi i rezultateve të konsultimit</li> </ul> <b>3.1.b</b> Cilësia* e strukturave dhe mekanizmave për dialog dhe bashkëpunim mes OS-hC-ve dhe institucioneve publike  * në aspektin e: <ul style="list-style-type: none"> <li>• përfaqësimit të OS-hC-ve në përgjithësi</li> <li>• përfaqësimi i OS-hC-ve më të vogla/ më të dobëta</li> <li>• vizibiliteti dhe dispozicioni</li> <li>• perceptimi qeveritar i cilësisë së strukturave dhe mekanizmave</li> <li>• Si perceptohen strukturat dhe mekanizmat nga ana e OS-hC-ve</li> </ul>	

Kapacitetet e OShC-ve			
4. OShC të afta, transparente dhe me përgjegjësi	4.1 Strukturat e brendshme qeverisëse të OShC-ve janë transparente dhe të përgjegjshme ndaj anëtarëve/ pjesëve përbërëse/ përfituesve	4.1.a Përqindja e OShC-ve që publikojnë strukturën e tyre qeverisëse dhe dokumentet e brendshme (statutet, rregullat e sjelljes etj.)	4.1.a Bazuar në shembull ose regjistrat nacionale
	4.2 OShC-të mund t'i komunikojnë rezultatet e aktiviteteve të tyre para publikut	4.2.a Perceptimi i jashtëm i rëndësisë dhe ndikimit të aktiviteteve të OShC-ve.	4.2.a Nga CIVICUS CSI
	4.3 OShC-të janë transparente lidhur me aktivitetet programore dhe menaxhimin e tyre financiar	4.3.a Përqindja e OShC-ve që i publikojnë raportet vjetore dhe llogaritë e tyre financiare (të reviduara)	4.3.a Në bazë të shembullit ose regjistrave nacionalë (nëse janë në dispozicion)
	4.4 OShC-të mbikqyrin dhe vlerësojnë rezultatet dhe ndikimin e punës së tyre	4.4.a Numri i OShC-ve që mbikqyrin dhe vlerësojnë projektet dhe programet e tyre duke përdorur bazat dhe treguesit e cilësisë	4.4.a Sondazh dhe vlerësim i shembullit të OShC-ve
5. OShC-të efektive	5.1 Aktivitetet e OShC-ve udhëhiqen me planifikim strategjik afatgjatë organizacional	5.1.a Numri i OShC-ve që kanë zhvilluar plane strategjike, përfshirë këtu planifikimin e aktiviteteve zhvillimore të burimeve njerëzore, në mënyrë që të joshin dhe të ruajnë talentet 5.1.b Përqindja e OShC-ve që mbikqyrin dhe vlerësojnë zbatimin e strategjive të tyre dhe e bëjnë këtë informacion publik të disponueshëm/ të hapur 5.1.c Përqindja mesatare e OShC-ve buxheti i ndarë për zhvillim të burimeve njerëzore ose zhvillim organizacional	5.1.a, 5.1.b dhe 5.1.c Në bazë të sondazhit /shembullit

Kapacitetet e OShC-ve			
	5.2 OShC-të përdorin hulumtim dhe forma të tjera të provave për të përforcuar aktivitetet e tyre	5.2.a Numri i OShC-ve që shfrytëzojnë argumente adekuate dhe analiza për arritjen e qëllimeve të mbështetjes	5.2.a CIVICUS (treguesi i mbështetjes i bazuar në evidencë) dhe/ose bazuar në sondazh/ shembull mbi përdorimin e vetë-vlerësimit në sondazh
	5.3 OShC-të rritëzohen rregullisht përbrenda dhe jashtë kufijve të vendit dhe shfrytëzojnë ndërtimin e koalicionit për ndikim më të madh në fushata dhe përkrahje	5.3.a Pjesa e OShC-ve që marrin pjesë në rrjetet lokale, nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare	5.3.a Anketë dhe hulumtim
6. OShC-të e qëndrueshme financiare	6.1 Aktivitetet për mbledhjen e fondeve janë rrënjësor në planet afatgjatë strategjike të OShC-ve dhe misionin kryesor të organizatës	6.1.a Përqindje e OShC-ve që konfirmojnë se janë në gjendje të mbledhin fonde në bazë të planeve të tyre strategjike	6.1.a Bazuar në anketë/ shembull
	6.2 OShC kanë bazë të shumëllojshme të financimit, përfshirë këtu edhe kuotat e anëtarësimit, dhurimin individual/ të korporatave dhe ndërmarrësinë sociale	6.2.a Shumëllojshmëria e burimeve të të ardhurave të OShC-ve	6.2.a Shembull dhe anketë







Bashkimi European